

VENDIM
Nr. 94, datë 12.2.2025

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I SEGMENTIT RRUGOR ‘SHËN GJERGJI’ –
‘NAUN KAÇAKU’ (ISH-URA ME SHKALLË–STACIONI I PATOSIT), FIER”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i segmentit rrugor ‘Shën Gjergj’–‘Naun Kaçaku’ (ish-ura me shkallë–Stacioni i Patosit), Fier”, Bashkia Fier.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Fier.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 13 684 429 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e njëzet e nëntë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 13 684 429 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e njëzet e nëntë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Fier.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Fier.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Fier.
8. Bashkia Fier kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Fier.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Fier për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Fier për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Fier, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “RIKONSTRUKSIONI I SEGMENTIT RRUGOR ‘SHËN GJERGJ’ – ‘NAUN KAÇAKU’ (ISH URA ME SHKALLË-STACIONI I PATOSIT)”

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)						Vlerësimet për shpronësim						Shënime (D+E) (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)	
										"Truall"			"Ndërtëse"				Vlera totale (lekë)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	"Truall" (m²)	"Ndërtëse" (m²)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (m²)	Vlera (lekë)		
1	Dritan Etleva	Koli Bari	Stamo Stamo	8531	3/113	Truall	55.00	55.00	55.00	55.00	12458.00	685,190	55.00		1085259.00	1,770,449	
2	Fatmir Naso	Xhemal	Zeqiraj Zeqiraj	8531	3/790	Truall	67.00		31	67	12458.00	834,686	31		702,115	1,536,801	
3	Florjan	Vasillaq	Dore	8531	3/145	Truall	268.00			58	12458.00	722,564				722,564	
4	Margarita Stavri	Zoimihal	Maqina Maqina	8531	11/344	Truall	267		89.1	24.00	12458.00	298,992				298,992	
5	Margarita Stavri	Zoimihal	Maqina Maqina	8531	11/342	Truall	28		27.7	12.00	12458.00	149,496	27.70		558,363	707,859	
6	Marjana	Koli	Prifti (Stamo)	8531	3/791	Truall	60		45	60.00	12458.00	747,480	45.00		908,231	1,655,711	
7	Jovan Raimonda	Petro Lam	Vasili Vasili	8531	14/284	Truall	300		79.2	36.00	12458.00	448,488				448,488	
8	Mimoza	Koli	Dashi (Stamo)	8531	3/792	Truall	60			60.00	12458.00	747,480				747,480	
9	Adriana	Koli	Verkaj (Stamo)	8531	3/117	Truall	60			60.00	12458.00	747,480				747,480	
10	Bledar Aspasiamarjana	Vasillaq Kristo Vasillaq	Shollo Shollo Shollo	8531	3/855	Truall	431		110.2	50.00	12458.00	622,900				622,900	
11	Maksim Maksim Edlira Violeta	Dhionis Dhionis Dhionis Lili	Shollo Shollo Shollo Shollo	8531	3/853	Truall	230		101.2	27.00	12458.00	336,366				336,366	
12	Kristul	Vasil	Tase	8531	1/118	Truall	87.34		62.2	28.00	12458.00	348,824				348,824	
13	Anesti	Spiro	Vasili	8531	14/4	Truall	413.25		74.5	102.40	12458	1,275,699				1,275,699	
14	Armand		Shametaj	8531	11/305	Truall	100.9		82.19	10.65	12458	132,678				132,678	
15	Dhori	LLazi	Suku	8531	3/500	Truall	342		43.61	33.40	12458	416,097				416,097	
16	Sotir	LLazi	Suku	8531	3/18	Truall	166.42		46.97	31.00	12458	386,198				386,198	
17	Budris Drita	Bujarkol	Bejleraj Bejleraj	8531	3/146	Truall	268			47.80	12458	595,492				595,492	
18	Alfred Klaritaliri Marjana	Irakli Irakli Irakli	Papingu Papingu Papingu	8531	1/81	Truall	445.8		143.36	75.00	12458	934,350				934,350	
VLERA TOTALE																13,684,429	